

**KUSHTET E PËRGJITHSHME  
PËR SIGURIMIN E Përgjegjësive së TRANSPORTUESIT  
(C.M.R.)**

**1. OBJEKTI I KONTRATËS SË SIGURIMIT.**

Objekt i kësaj kontrate sigurimi është përgjegjësia kontraktuale e të siguruarit si transportues rrugor në përputhje me konventën CMR, për humbje pjesore ose totale të provuara, dëmtime ose shkatërrime në dorëzimin e mallrave që janë duke u transportuar me dokumente ose kontratë transporti, nga momenti i marrjes së mallit në ngarkim deri në dorëzimin e tij, bazuar në kushtet e rëna dakort ndërmjet palëve në Policën e Sigurimit, bazuar në Konventën për Kontratën e Transportit Ndërkombëtar të Mallrave me Rrugë Tokësore (C.M.R.) ratifikuar në Republikën e Shqipërisë me ligjin nr. 9503 datë 03.04.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për kontratën e transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave (CMR) dhe protokollin e nënshkrimit”

**2. SHTRIRJA TERRITORIALE**

Kjo policë do të zbatohet për transportin e mallrave brënda EUROPES duke përfshirë Turqinë, përjashtuar të gjitha shtetet që kanë qenë pjesë e ish Bashkimit Sovjetik.

Ky sigurim mbulon çdo kërkesë për dëmshpërblim që shkaktohet nga zjarri, aksidentet apo vjedhja vetëm nëse ato kanë ndodhur si shkak i përgjegjësive së transportuesit. Rreziku i vjedhjes është përjashtuar nëse trajleri / kontejneri mbërrin tek pritësi me vulë të pa dëmtuar.

Siguruesi përgjigjet për humbjen tërësore ose pjesore të mallit dhe për dëmtimin e tij, që ndodh nga momenti kur transportuesi merr në dorëzim mallin deri në momentin e dorëzimit.

**3. PËRJASHTIME**

Kjo policë nuk mbulon përgjegjësinë në lidhje, që lind apo që shkaktohet nga:

- a. Mungesa ose gjendja me defekt e paketimit në rastin e mallit që nga natyra e tij mund të firojë ose dëmtohet nëse nuk është i paketuar ose nuk është paketuar si duhet;
- b. Natyra e disa llojeve të mallrave që i ekspozon ata kundrejt humbjes së plotë ose pjesore ose dëmtimit; sidomos nëpërmjet thyerjes, ndryshkjes, kalbëzimit, tharjes, rrjedhjes, firos se zakonshme ose veprimi të molës, ose insekteve;
- c. Transportimi i kafshëve
- d. Gabimet e fshehura apo natyra e vetë mallit nën kontrollin e të Siguruarit.
- e. Mungesa në volum apo peshë brenda standarteve të pranuar për mungesa natyrore.
- f. Përdorimi nga i Siguruari i mjeteve jo të përshtatshme për transportin e një lloji të caktuar malli ose një mjeti që nuk përmbush standartet teknike.
  
- g. Përdorimi i mjetit nga persona pa licencën e kualifikimit të përshtatshëm / pa lejen përkatëse të drejtimit;
- h. Konsumimi i alkoolit, intoksikanteve ose substancave të tjera që kanë veprim të ngjashëm nga persona që ngasin mjetin ose persona të tjerë që veprojnë në emër të të Siguruarit.
- i. Një gabim me ndërgjegje apo neglizhencë e madhe e të Siguruarit, menaxherëve apo nënkontraktorëve të tij.

- j. Lënia e mallrave që transportohen ose e mjetit pa kujdes ose pa ruajtje. Ky përjashtim nuk do të merret në konsideratë nëse kamioni është i pajisur me GPS dhe sistem të ruajtjes nga vjedhja të miratuar nga Siguruesi si dhe nëse evidentohet se ky sistem ishte në punë në kohën e vjedhjes.
- k. Transporti i makinave të reja apo të përdorura
- l. Transport i duhanit apo cigareve
- m. Transporti i pijeve alkolike
- n. Transporti i mobiljeve
- o. Transporti i mallrave në frigorifer, ose në tankera me ajër të kondicionuar, përveç rasteve kur bihet dakort në mënyre specifike. Në këto raste nuk mbulohet prishja e sistemit të ftohjes për arsye të tjera përveç rastit kur ka aksident automobilistik të vërtetuar me raport policie.
- p. Transporti i mallrave që i kalojnë përmasat e mjetit të transportit
- q. Dëmet që ndodhin gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të mjetit të transportit
- r. Transporti i mallrave nga shërbimi postar, veprave të artit dhe muzeale, koleksione numizmatike dhe filatelike, antikuarë dhe të ngjashme të rralla ;
- s. Dëmet që i ndodhin vetë kontejnerit në rastin e transportit me kontejner
- t. Siguruesi nuk është i detyruar të kompensojë të siguruarin për kostot e dëmtimeve gjatë transportit të paketimeve si paletat, karrocet apo mbajtësve.
- u. Kërkesa për dëmshpërblim nga personat që transportohen.
- v. Gjobat e vëna të Siguruarit ose punonjësve të tij.
- w. Konfiskimi i ngarkesës nga autoritetet kompetente. Është e përjashtuar kërkesa për dëmshpërblim që vjen nga mospërmbushja e kushteve të lëvrimit të mallit.
- x. Humbja dhe dëmtimi i mallrave të rrezikshëm sipas kodit, hidrokarbureve, mallrave të ngrira, veprave të artit, koleksioneve të pullave dhe monedhave, dokumenteve, çeqeve, platinë, arit, gurëve të çmuar dhe artikujve të tjerë të ngjashëm.
- y. Humbjet që lindin nga pranimi prej të Siguruarit i një përgjegjësie më të madhe mbi vlerën reale të ngarkesës (Art 26 i CMR)
- z. Dëmtime që vijnë nga forca madhore, katastrofat natyrore, luftrat dhe luftrat civile, aktivitetet revolucionare dhe përdorimit të energjisë bërthamore apo materialeve radioaktive.
- aa. Çdo humbje apo dëm që vjen si pasojë e mungesës së aftësisë paguese.
- bb. Përdorimi i gabuar apo i pasaktë i dokumentacionit, përfshi plotësimin e faturave CMR; përveç vlerës së mallit të dëmtuar, përjashtohet çdo pagesë tjetër që ka të bëjë me taksa/tarifa doganore, shpenzime transporti etj.

Sipas këtyre Kushteve të përgjithshme nuk do të jetë pjesë e këtij sigurimi:

- a. Përgjegjësia e përgjithshme nga aktiviteti i të siguruarit
- b. Përgjegjësia e të siguruarit për dëmet shkaktuar të tretëve; për dëmet pasurore të të tretëve, për dëm me vdekje/dëmtime trupore, dëme të shëndetit të palëve të treta, dhe për dëme ekologjike.

#### 4. PRIMI

Bazë për kalkulimin e Primit është kompensimi bruto i ngarkesës, pa përfshirë taksat dhe tarifën e transportit rrugor.

- 1. I Siguruari është i detyruar të raportojë tek Siguruesi në fund të çdo muaji kalendarik, por jo më vonë se data 5 e muajit pasardhës, për të gjithë transportet që janë të mbuluar nga policia e sigurimit CMR.
- 2. Mbulimi me sigurim fillon në orën 24.00 të datës që paguhet primi i sigurimit.

3. Nëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transport, policëmbajtësi duhet të bëjë një raport negativ brenda kohës së njoftimit, pa paguar kosto shtesë.
4. Siguruesi do të jetë i autorizuar të kontrollojë deklaratimet e të siguruarit duke inspektuar regjistrat e biznesit dhe dokumente të tjera. Ai është i detyruar të ruajë sekretin për njohuritë që mund të marrë lidhur me biznesin e policëmbajtësit, të mos ua jap të tretëve apo ta përdor për qëllime të tjera.
5. Nëse i Siguruari nuk zbaton këto detyrime, Siguruesi nuk do të jetë i detyruar të paguajë vlerën e dëmit.

Nëse i Siguruari shkel me dashje detyrimet e deklaruara, Siguruesi mund të anullojë policën pa njoftuar; primet e paguara ose jo, i takojnë Siguruesit, të plota siç do ti kishin arkëtuar deri në përfundim të kontratës, sikur kjo të ishte e rregullt.

## **5. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PËRGJITHSHME .**

Është detyrim i të siguruarit:

- Të përzgjedhë shoferët dhe/ose transportuesit me kujdesin e një biznesmeni dhe nën përgjegjësinë e tij. Një listë emërore me vitet e punës përkatës për çdo drejtues mjete i duhet dorëzuar Siguruesit para se të nënshkruhet Kontrata. I siguruari duhet të njoftojë Siguruesin dhe miratimin nga ai në rast se merr mjete ose drejtues mjete nga të tretë.
- Të sigurohet që ngarkesa ruhet siç duhet gjatë transportit, veçanërisht gjatë parkimit, periudhës së pritjes apo pushimit. Nëse palët do të nënshkruajnë një kontratë vjetore, atëherë detyrimisht do të vendoset në të gjithë kamionët e të Siguarit pajisja GPS e kompanisë Sigal Uniqa Group Austria sh.a.
- Të sigurohet në çdo kohë për gjendjen e mirë teknike të mjetit dhe tendën e kamionit; të riparohet menjëherë çdo mangësi. Parkimet duhet të jenë vetëm në rajone të autorizuar dhe të survejuara.
- Nëse i siguruari, përfaqësuesit e tij ligjorë, nënshkruhet e autorizuar ose nënkontraktorët dhe manaxherët e pavarur të degëve, shkelin ndonjë nga detyrimet më sipër, me dashje apo pa dashje, Siguruesi do të çlirohet nga detyrimi për të paguar dëmin.
- Nëse i siguruari shkel detyrimet e parashikuara nga ligji ose Kontrata, Siguruesi do të çlirohet nga detyrimi për të paguar dëmshpërblimin në përputhje me Ligjin për Kontratën e Sigurimit (Kodi Civil).

I siguruari e humb të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim edhe në rastet kur rreziku është i mbuluar në sigurim por i Siguruari nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe ligjore, si më poshtë:

1. Në rast të dëmit nga vjedhja apo grabitja e ngarkesës kur:
  - Kamioni është i parkuar në një vend parkim pa mbikqyrjen dhe praninë e shoferit apo shoqëruesve të tij
  - Kamioni nuk vendoset në një parkim të mbyllur apo kufizuar me gardh, të ndriçuar, dhe me 24 orë roje, në rastet kur largohet shoferi apo shoqëruesit e tij
  - Nëse kamioni nuk është i vendosur në një parking të mbyllur, të ndriçuar dhe me 24 ore roje, për rastet kur malli që transportohet është duhan, cigare, pije alkoolike, goma makinash, kompjutera apo pjesë të tyre, video pajisje, televizorë, celulare, produkte kozmetike,
  - Gjatë mbushjes me karburant shoferi nuk është pranë kamionit, nëse kamioni nuk është i mbyllur dhe nën mbikqyrjen e shoferit.
  - Trajleri apo gjysëm trajleri nuk është i ngjitur me kokën gjatë parkimit
  - Në rast vjedhje të të gjithë kamionit me mall, shoferi nuk paraqet të 2 çelësat origjinale të mjetit.
  - Në rast se transporti është bërë me mjete që nuk janë të deklaruara në kohën e lidhjes së kësaj kontrate, përveç rasteve kur për nevoja të veçanta i Siguruari angazhon mjete të tjera dhe i deklaron ato përpara transportit.

2. Siguruesi nuk do jetë përgjegjës për të dëmshpërblyer dëme të shkaktuara në rrethana të cilat e përjashtojnë nga përgjegjësia sipas kushteve të Konventës CMR ratifikuar me ligj, për arsye të:
  - Veprime të qëllimshme dhe pa kujdes të personit të autorizuar për të asgjësuar mallrat apo urdhërat e tij që i ka dhënë gabimisht
  - Defektet e vetë mallrave
3. Nuk ka detyrim për siguruesin të paguajë dëmshpërblim nga ky siguracion nëse është dukshme që humbja totale apo pjesore e dëmit ka ndodhur, dhe i Siguruari nuk e provon dot të kundërtën, nga rreziqe të veçanta të lidhura me:
  - Përdorimi i një mjete transporti të hapur pa tendë, përveç kur është rënë më parë dakort për transport të tillë
  - Paketimi i keq për mallrat që janë të pritshme që mund të thyhen
  - Përpunimi, ngarkimi, stivosja dhe shkarkimi i mallrave nga dërguesi apo pritësi, ose persona të cilët punojnë me urdhër të dërguesit apo pritësit.
  - Gjendja natyrale e mallrave, të cilat janë të pritshme të dëmtohen plotësisht apo pjesërisht (thyerje, ndryshkja, kalbja, tharja, rrjedhja, prishja normale, sulmi nga tenja dhe brejtësit)
  - Mungesa, josaktësia dhe joplotësia e numrave të tabelave apo paketimeve
  - Transporti i kafshëve të gjalla

**Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për dëme që vijnë nga:**

- Dëme të shkaktuara nga rrethana që e përjashtojnë të siguruarin nga përgjegjësia sipas kushteve të ligjit dhe të Konventës CMR
- Dëmet e shkaktuara direkt ose indirekt nga veprimi i qëllimshëm apo neglizhenca e theksuar e të siguruarit apo përfaqësuesve të tij ligjore. Neglizhenca e theksuar kuptohet si një veprim apo gabim në të cilin ndodhia e dëmit pritej që të ndodhte dhe që i Siguruari e dinte, duhej apo mund ta kishte ditur që një veprim ose gabim i tillë mund të shkaktonte dëme pa arsye të justifikueshme që dëmi nuk do kishte ndodhur.
- Dëme të shkaktuara direkt apo indirekt nga performanca e transportuesit nën efektin e substancave psikoaktive (alkooli, narkotiket etj.)
- Dëme si pasoje e defekteve apo e mirëmbajtjes së dobët ose moskryerjes së serviseve të makinës siç duhet. Makinë e servisuar kuptohet kamioni që është teknikisht korrekt dhe ka kaluar të gjitha inspektimet teknike sipas rregullave të vendit dhe që ka një Siguracion të vlefshëm ndaj palëve të treta.
- Dëme që ndodhin gjatë ngarkimit apo shkarkimit në zona që nuk janë magazina të mbyllura dhe të përshtatshme sipas Konventës së CMR
- Dëme në transporte për nevoja vetiake
- Dëme të paguara nga i Siguruari pa miratimin paraprak të Siguruesit
- Dëme të ndodhura nga lufta, edhe nëse nuk është shpallur ajo, sabotazhi, grevat revolucionari, kryengritja, trazirat civile, dhuna apo bllokada, konfiskimi ose të ngjashme;
- Dëme të ndodhura direkt ose indirekt nga veprime terroriste, ose përpjekjeve për të ndaluar një akt të tillë.

**6. DETYRIMET E TË SIGURUARIT NË RAST KËRKESE PËR DËMSHPËRBLIM**

Është detyrim i policëmbajtësit:

- 6.1 Të raportojë tek Siguruesi menjëherë, por jo më vonë se 24 orë, për çdo ngjarje që rezulton me kërkesë për dëmshpërblim kundrejt tij, në përputhje me marrëveshjen e transportit sipas kësaj police.
- 6.2 Të raportojë sa më shpejt në stacionin më të afërt të policisë çdo aksident rrugor, vjedhje apo dëm.

6.3 Të sigurojë shmangien dhe zvogëlimin e humbjeve të dëmit; të furnizojë siguruesit me çdo informacion të nevojshëm dhe të ndjekë të gjitha Instruksionet Teknike dhe ato të Siguruesit.

6.4 Në rast dëmi, siguruesit duhet ti dorëzohet dokumentacioni i mëposhtëm:

a - Raport dëmi ; do të përdoret formulari i përgatitur nga Siguruesi. Formulari duhet të nënshkruhet nga policëmbajtësi, i siguruari dhe drejtuesit e mjetit.

b - Policë ngarkesa; në rast ngarkese në grup, të paraqitet Listë Ngarkesa.

c - Fatura origjinale e mallit të ngarkuar.

d - Fatura e dëmit.

e - Raporti ose certifikata e investigimit.

f - Njoftimi i bërë tek autoritetet policore dhe nëse është e mundur një kopje e raportit të policisë.

g - Foto që vërtetojnë aksidentin dhe mallin e dëmtuar;

h - Çdo dokument tjetër në interes të aksidentit të ndodhur dhe kërkesës për dëmshpërblim; barra e provës për të vërtetuar humbjen apo dëmin, i bie transportuesit.

6.5 Nëse pas një inspektimi të mjetit, është ndërmarrë një procedurë penale, i Siguruari është i detyruar të informoje Siguruesin menjëherë, edhe kur e ka lajmëruar më parë ngjarjen e ndodhur. Ai duhet që t'ja tregojë Siguruesit Raportin me gjetjet që ka bërë Autoriteti i inspektimit.

## **7. MEDIKAMENTE TË RREZIKSHME**

Asnjë kërkesë për dëmshpërblim sipas kësaj Police nuk do të paguhet në lidhje me medikamentet për të cilat zbatohen Konventat Ndërkombëtare që lidhen me Opiumin dhe medikamentet e tjera të rrezikshme, përveç:

- a. Kur medikamenti do të deklarohet shprehimisht si i tillë në faturën e ngarkesës, emri i vendit të origjinës dhe emri i vendit të destinacionit do të shënohen veçanërisht në faturën e ngarkesës, dhe
- b. Vërtetimi i kësaj duhet të shoqërohet ose me licensë, certifikatë ose autorizim të lëshuar nga qeveria e vendit në të cilin ngarkesa është drejtuar, që të tregojë se importimi i kësaj ngarkese për në destinacionin e deklaruar është aprovuar nga kjo qeveri, dhe
- c. rruga nëpër të cilën medikamentet janë transportuar është normale dhe e rregullt.

## **8. KUJDESI I DOMOSDOSHEM**

I Siguruari është i detyruar të marrë të gjitha masat e arsyeshme e të domosdoshme për të ruajtur dhe mbrojtur mallrat që transporton duke përdorur të gjitha pajisjet mbrojtëse siç është specifikuar në Policë. Të gjitha mjetet dhe pajisjet mbrojtëse duhet të njihen e të përdoren me efikasitet nga transportuesi; ato duhet të mirëmbahen siç duhet. Këto pajisje do të jenë sipas Standarteve dhe nuk do të ndryshojnë apo hiqen pa aprovim me shkrim nga Siguruesi.

Në rast të një aksidenti i cili ndodh si një përgjegjësi e të Siguarit ose e të punësuarve të tij, i siguruari ose punonjësit do të ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshme, edhe pa miratim të Siguruesit, për minimizimin, kufizimin e dëmit/humbjes dhe rivendosjen, riaftësimin dhe/ose ruajtjen e mallrave në ngarkim.

Kjo Policë nuk mbulon ndonjë përgjegjësi, humbje apo dëm i cili në kohën ndodhjes së kësaj humbjeje apo dëmi është i siguar nga ndonjë Policë tjetër, përveç për pjesën e siguar mbi shumën e cila do të kishte qenë paguar sipas kësaj Police nëse ky sigurim nuk do të kishte qenë efektiv.

## **9. NDËRPRERJA**

Kjo Policë mundet të ndërpritet në çdo kohë mbas një njoftimi 15 ditë përpara me shkrim. Siguruesit mbasi marrin njoftim do të marrin apo mbajnë pjesën proporcionale apo të paguar, duke përfshirë periudhën e kaluar dhe shpenzimet administrative deri në kohën e dhënies së njoftimit.

## **10. PROCEDURA E KËRKESËS PËR DËMSPËRBLIM**

Në rast të një ngjarjeje që bën të lindë një kërkesë për dëmshpërblim e të Siguararit në lidhje me mallrat që transportohen, i Siguarari duhet sa me shpejt që të jetë e mundur të njoftojë për këtë Siguruesin dhe ta furnizojë atë me të gjitha të dhënat. Çdo letër, njoftim, shkresë, relacion, foto që lidhet me ngjarjen do të njoftohet ose dërgohet tek Siguruesi menjëherë sa të merret.

I Siguarari nuk do të paguaje ose pranojë, dëmshpërblim në lidhje me një kërkesë për dëmshpërblim nga ose në emër të Siguruesit, pa pranimit me shkrim të Siguruesit.

I Siguarari do kërkojë miratim nga Siguruesi përpara pranimit të çdo detyrimi dhe duhet të përmbushë instruksionet që ai merr në lidhje me këtë nga Siguruesi. Ky kusht do të zbatohet edhe kur përgjegjësia e të Siguararit është vendosur nga Gjykata dhe për këtë i Siguarari nuk e ka njoftuar Siguruesin në kohë, në mënyrë që ai të merrte masa për këtë proces.

Nëse pala e dëmtuar hap një proces gjyqësor për dëme kundër të Siguararit, i Siguarari është i detyruar që të gjitha dokumentacionet e dosjes gjyqësore dhe çdo dokument që lidhet me këtë ngjarje, t'ja kalojë dhe njoftojë Siguruesit.

Siguruesi do të emërohet të ndërmarrë dhe drejtojë në emër të të Siguararit mbrojtjen ose trajtimin e çdo kërkesë për dëmshpërblim ose dëmi dhe do të ketë të drejta të plota për drejtimin e çdo procedure në trajtimin e çdo kërkesë për dëmshpërblim, ndërsa i Siguarari do të japë atë informacion dhe ndihmë që do të kërkojë Siguruesi.

## **11. KALIMI I TË DREJTAVE**

I Siguarari duhet që, me kërkesën dhe shpenzimet e Siguruesit, të ndihmojë dhe lejojë të bëhen të gjitha veprimet të cilat në mënyrë të nevojshme dhe të arsyeshme kërkohen nga Siguruesi për qëllime të forcimit të të drejtave ose për të përfituar lehtësim apo dëmshpërblim nga palët e tjera për të cilat Siguruesi do të bëhet apo emërohet apo do të kalojnë të drejtat mbas pagesës së çdo kërkesë për dëmshpërblim që lind sipas kësaj Police, nëse ky veprim do të bëhet i nevojshëm ose kërkohet përpara ose pas dëmshpërblimit nga Siguruesi.

Nëse agjentë apo nënkontraktorë të policëmbajtësit kanë shkaktuar një dëm qëllimisht, për shkak të neglizhencës apo duke shkelur detyrime, Siguruesi ruan të drejtën për Rekurs kundrejt tyre, pasi ta ketë paguar më parë dëmshpërblimin.

## **12. NËNKONTRAKTORËT DHE/OSE TRANSPORTUESIT E DYTË**

Shprehja “gjatë transportit” përmbledh edhe transportin nëpërmjet nënkontraktorëve dhe/ose transportuesit e dytë dhe/ose trailerët dhe/ose kontejnerët duke përfshirë dhe këto nene dhe kushte shtesë:

- a. I Siguarari duhet të sigurohet që të gjithë nënkontraktorët dhe/ose Transportuesit e dytë mbajnë siguracion të vlefshëm sipas të cilit kufiri i mjetit dhe/ose trailerit dhe/ose kontejnerit është i mjaftueshëm të mbulojë vlerën e kamionit të nënkontraktuar (përfshi të gjitha detyrimet Doganore apo të tjera detyrime) dhe që në të gjitha aspektet mbulimi nga ky siguracion nuk është me pak i vlefshëm se mbulimi që jep kjo Policë, dhe i Siguarari do të marrë konfirmim me shkrim për këtë mbulim nëse kërkohet nga Siguruesi.
- b. Asnjë përfitim nga kjo policë, në asnjë rrethanë, nuk do të kalojë tek nënkontraktorët dhe/ose transportuesit e dytë ose tek siguruesit e tyre.

- c. Është një nga kushtet parësore të përgjegjësisë së Siguruesit sipas kësaj Police që për çdo kërkesë për dëmshpërblim e cila lind nga transporti me mjete dhe/ose trailerët dhe/ose kontejnerët e nënkontraktoreve dhe/ose transportuesve të dytë, pasuria nuk do të lëvrohet nga i Siguruari ose punonjësit e tij, dhe i Siguruari do të marrë të gjitha masat e nevojshme për tu siguruar se pasuria nuk është lëvruar nga pronarët apo punonjësit e tij tek ndonjë person që pretendon të jetë nënkontraktor dhe/apo transportues i dytë përveç *bona fides* e këtij personi do të jetë kryer nën kushte të arsyeshme.

### **13. PJESA QË NUK MBULOHE**

Pjesa e Zbritshme është ajo vlerë e shënuar në policën e sigurimit për të cilën i siguruari është i përjashtuar nga pagesa e dëmit apo humbjes; e cila shprehet në % ose vlerë minimale.

### **14. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE**

I siguruari është njohur me deklaratën e privatësisë të shoqërisë së sigurimeve dhe autorizon SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a që të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të siguarit dhe përfituesit përfshirë trajtimin e dëmit, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatëse në fuqi (Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”) si dhe transferimin e të dhënave personale tek te tretë për qëllime të sigurimit apo biznesi të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale. Ne çdo rast, mbrojtja e të dhënave personale do të bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

### **15. E DREJTA E INFORMIMIT**

- I siguruari ka të drejtën të informohet nga Siguruesi mbi kushtet, procedurat dhe afatet e mbulimit dhe/ose përfitimit nga sigurimi, informim i cili fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Informimi merret nëpërmjet telefonit, e-mailit, faqes zyrtare në internet apo broshurave informative të përdorura nga shoqëria.

- I siguruari është informuar nga Siguruesi përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, duke marrë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me të dhënat juridike të siguruesit, llojin përkatës të sigurimit, procedurat, afatet, metodat e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara, metodat e llogaritjes, afatet dhe mënyra e pagesës së primit, metodën e llogaritjes së vlerës së kompesueshme dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me kontratën e sigurimit.

### **16. E DREJTA E TË SIGURUARIT PËR TU ANKUAR**

I siguruari apo persona të tjerë të interesuar, kanë të drejtë të paraqesin një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit, në rast se çmojnë se shoqëria e sigurimit nuk u përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit. Ankesa mund të paraqitet në formë elektronike (e-mail) ose me shkrim në adresën postare të shoqërisë. Shoqëria e sigurimit do të përgjigjet çdo ankese të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe do të jap çdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda afateve të përcaktuara në ligj.

## **17. KUFIZIMET E SANKSIONEVE DHE KLAUZOLA PËRJASHTUESE**

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë sigurimi ofron mbulim për aq sa mbulimi me sigurim nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo klauzole gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.”

Kushtet e kësaj kontrate sigurimi nënshkruar me SIGAL UNIQA Group janë njohur dhe pranuar nga palët, në kuptim të nenit 686 të Kodit Civil.

Palët pranojnë që kjo është një kontratë e negociuar dhe pranuar me vullnet të lirë dhe të plotë. Fakti që njëra Palë e kontratës ka hartuar kontratën apo një dispozitë të caktuar të saj apo se ajo përfiton nga ajo dispozitë nuk do të përdoret kundër saj në interpretimin e kushteve të kontratës, por do të konsiderohet si rregullim i synuar kontraktor i marrëdhënies mes palëve.

Kjo kontratë sigurimi hartohet dhe zbatohet në përputhje me kushtet e përcaktuara si më sipër, Kodin Civil, Ligjin nr.52 të vitit 2014 “Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve”

**PAGESA E PRIMIT TË SIGURIMIT DHE LËSHIMI I POLICËS TË SIGURIMIT VERTETOJNË SE PALËT KANË RËNË DAKORT ME INFORMACIONIN E DHËNË PARAPRAKISHT, KANË LEXUAR DHE KUPTUAR TË GJITHA TERMAT DHE KUSHTET E KËSAJ KONTRATE SIGURIMI, DHE PRANOJNË ME VULLNET TË LIRË T’I RESPEKTOJNË DHE ZBATOJNË ATO.**

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sha**